



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS
KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 27 maj 2025 , në mbledhjen e XXXV-të (tridhjetepesë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:20.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Sebastina Vokri; Bashkim Sylja; Mrika Thaçi) bashkëngjitur lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje e pranishëm ishin edhe; *Marigonë Lahu Nënkrjetare e Komunës; Fatlum Osmani drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave DBF; Saranda Stublla drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ;*

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, konstatoi kuorumin, ndër të tjera theksoi, thirrja dhe materiali i kësaj mbledhje besoj të gjithëve ju është dërguar dhe e keni pranuar me kohë, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës fillimisht.

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, para se të miratohet rendi i ditës më lejoni që t'i paraqes edhe tri propozim vendime si pika shtesë që kanë të bëjnë me një parcelë në zonën kadastrale Lupç i Poshtëm, për dhënie në shfrytëzim, mirëpo para se të shkojmë te propozim vendimi për dhënie në shfrytëzim, e kemi sjellë një propozim vendim që të bëhet ndryshimi përkatësisht riformulimi i të dhënave në kuadër të Listës të veçantë të pronave të Komunës së Podujevës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025, ku edhe është cekur periudha kohore e dhënies në shfrytëzim që ka qenë afatshkurtër e që propozohet të bëhet afatgjatë, pra fjala është për parcelën me nr.202-3 në sipërfaqe 13 hektar e 71 ari e 57 metër në Zonën Kadastrale Lupç i Poshtëm, pas kësaj kemi propozim vendimin për miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim të kësaj parcele dhe së fundi e kemi edhe propozim vendimin për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të kësaj prone.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pra kemi propozimet e cekura nga drejtoresha parafolëse për pika shtesë, materiali i këtyre propozimeve tani më veç ju është shpërndarë dhe tani për disa minuta mund ta shikojmë dhe ta shqyrtojmë, mandej e hedhim në votim.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ndoshta nuk e dëgjova mirë drejtoreshën por nuk e kuptova arsyen pse ta ndryshojmë afatin e dhënies në shfrytëzim nga afatshkurtër në afatgjatë dhe nëse kjo ndryshohet për sa vite është fjala për dhënie shfrytëzim afatgjatë, sa vite ka qenë afatshkurtër, si dhe arsyen pse të zgjatet kjo periudhë kohore.

z.Bashkim Sylja, theksoi, së pari dua të bëjë një pyetje lidhur me këtë, siç po e shoh unë propozimi është vetëm për një pronë, pra për njësinë kadastrale 202-3, pyetja ime ka të bëjë se ky propozim që e keni sjellë në këtu në KPF a është vetëm për këtë parcelë që të kaloj në periudhë afatgjatë dhe a jeni konsultuar me zyrën ligjore se a kemi drejtë ne si Kuvend Komunal që të japim pronën në periudhë afatgjatë.

z.Naim Çunaku, theksoi, edhe unë lidhur me këtë dua t'i paraqes disa shqetësime edhe rreth rendit të ditës si dhe për propozimin e ri që e ka sjell drejtoresha e DPKGJ.

Sa i përket rendit të ditës siç e kemi të propozuar komplet, pika për vazhdimin e pikës së nëntë, që ta trajtojmë pikën për dhënie në shfrytëzim Ndërmarrjes Komunale "Eko Llapi" parcelën e cekur, besoj se mund t'i jap sugjerimet dhe kam të drejtë sepse paraprakisht KPF është ai i cili debaton të gjitha pikat dhe i përgatit për Kuvend, pra kjo është puna e këtij Komiteti, nëse dikush nga ju nuk dëshironi e përfundojmë këtë temë por më mirë është të sqarohet sot se sa të sqarohet nesër në Kuvend ngase jemi duke folur për rend të ditës dhe nuk ka rëndësi se kush ka folur në fillim, pra çfarë rëndësia ka kjo, dhe nëse një seancë e ndërprende duhet të vazhdoj dhe do të duhet të ishte praktikë e kërkuar që prej kohesh që çdo seancë e ndërprerë duhet të marr epilogun e përfundimit dhe deri më tani seancat e ndërprera nuk kemi pasur rast duke përjashtuar raste siç ishte formimi i komisionit gjegjësisht pagesa për komisionarët e Komunës pra ajo është përsëritë dy-tri herë, ndërsa seancat tjera nuk janë përsëritur. Pra po e rrumbullakoj, nëse ka mbetur seanca pa përfunduar dhe nëse vazhdon pika e 9, përse atëherë të mos vazhdohet edhe pika 10 Të Ndryshme, pra edhe ajo të numërohet si ndërprerje që është cunguar.

Sa i përket propozimit që e bëri drejtoresha e DPKGJ, një nga kushtet kryesore për dhënien e një prone në shfrytëzim nga Komuna gjatë vitit e ka që Ligji e përcakton se prona të jetë e publikuar në faqen e Komunës deri me 31 dhjetor të vitit paraprak, kjo do të thotë që prona që Komuna jon ka menduar të jap gjatë vitit në shfrytëzim ligjërisht ka qenë e obliguar të jetë e publikuar dhe të merr miratimin në Kuvend para vitit 2025 sikurse të gjitha pronat që planifikohen për dhënie në shfrytëzim duhet të kenë arsyeshmërinë për dhënie në shfrytëzim gjegjësisht në bazë të rregullativës në fuqi si dhe Hartës Zonale interesi publik, i të mirës së përgjithshme publike, pra cila është arsyeja për dhënien në shfrytëzim.

Në këtë rast që tani është paraqitur ajo pronë që më herët u fol nuk e ka kaluar këtë procedurë, pra nuk ka qenë e planifikuar që të jepet në shfrytëzim, mos të mendon ndokush që po i mbaj barrë dikujt, pra është shumë keq ajo pronë qysh shfrytëzohet dhe nuk dihet se si shfrytëzohet dhe a ka rrjedhë ndonjë inkasim nga ajo pronë apo jo.

Tani po dal te propozimi konkret që e bëri drejtoresha e DPKGJ dhe dua të di se cila është arsyeja që një pronë e paraparë për dhënie në shfrytëzim për 10 vite tani t'ia ndryshojmë dhe ta bëjmë afatgjatë, pastaj unë dëgjova edhe te kolegët e mi që shfaqen dilemat se deri kur ka të drejtë Komuna, pra Komuna ka të drejtë deri 99 vite afatgjatë, kuptohet nga 15 deri 99 vite dhe këtu nuk është e përcaktuar se për sa vite Komuna ta jap në shfrytëzim, si dhe për një pronë e tillë a ish dashtë të kemi sqarim se a kemi konkurrent apo interesim potencial të ndokujt dhe çka mendohet destinimi i asaj prone. E them këtë sepse në fazat e më hershme ajo pronë është dhënë në shfrytëzim ku unë kam qenë anëtar i komisionit dhe është dhënë dy herë, ku një herë është dhënë një parcelë e ngushtë për ndërtimin e një fabrike te peletit.

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, nuk qëndron ajo që është dhënë kjo pronë dy herë sepse aty ka shumë parcela dhe ne jemi duke biseduar vetëm për një parcelë, pra kjo parcelë nuk është dhënë në shfrytëzim, është dal për dhënie në shfrytëzim por nuk është dhënë.

z.Naim Çunaku, vazhdoi, e nderuar drejtoresh, ajo pronë është dhënë dhe ka filluar të bëjë dikush deponi të mbeturinave të ngurta, mirëpo si do që të jetë unë po e përmbylli me një fjali, vazhdimisht prej që jam këtu si përfaqësues i qytetareve gjithmonë kam qenë Pro që potencialet e fjetura të Komunës të jepen në shfrytëzim me qëllimin e zhvillimit ekonomik dhe krijimin e mirëqenies së qytetareve, pra në parim gjithmonë jam për dhënien e pronave në shfrytëzim, mirëpo jo dhënie sipas sferave të ndikimit por dhënie sipas asaj që e përcakton ligji ku krijohen të hyra për Komunën dhe të ngritët mirëqenie dhe zhvillimi ekonomik i Komunës, andaj është mirë të na tregoni cili është qëllimi dhe apo bëjmë ndërhyrje në muajin maj në një vendim që nuk kemi të drejtë dhe është i mbyllur deri më 31 dhjetor 2024.

z.Haki Rudari, theksoi, te neni 2 i propozim vendimit shkruan se sipas planifikimeve vite me radhë është proceduar për dhënie shfrytëzim në periudhë afatshkurtër përmes ankandit publik por nuk ka pasur të interesuar për marrjen e kësaj prone në shfrytëzim, ndërsa interesimi që Komuna të japë pronën për periudhën afatgjatë, në rregull ne jemi për dhënien e pronës në shfrytëzim me qëllim të krijimit e të hyrave vetanake e të tjera por tek pjesa tjetër nuk parashihet se çka do të investohet e që mendoj se do të ishte mirë të specifikohet edhe kjo por edhe tek periudha për sa vite të jepet.

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, paraprakisht para se t'i sjell propozim vendimet në Kuvend jemi konsultuar me zyrën ligjore, pra në bashkëpunim me zyrën ligjore i kemi bërë këto propozim vendime, arsyeje se pse po bëhet ky ndryshim është që neve si organ na ka ikur si detaj kur e kemi përgatitur në muajin dhjetor të vitit të kaluar, dhe këtu janë të përshkruar të gjitha ato se çka parashihet me Hartë Zonale, pra të gjitha i kemi paraqitur në listë të veçantë, ndërsa këtu kemi të bëjmë vetëm me një parcelë zotëri Naim, jo për të gjitha, dhe e kemi të paraqitur edhe periudhën kohore të cilën e kemi planifikuar në listë të veçantë e që është periudha prill-qershor, mirëpo paraprakisht para se të sjellim si propozim vendim e kemi hasur që e kemi paraqitur si afatshkurtër dhe duhet të bëhet ky ndryshim, pra të bëhet afatgjatë, kjo është arsyeja.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ka të interesuar për të marr fjalën, nëse jo atëherë i hedhë në votim këto tri propozim vendime që të hyjnë si pika shtesë në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje, sipas materialit të prezantuar në këtë mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi konstatoi se nga 7 anëtarët prezent në sall, me 6 vota Për, asnjë votë Kundër, 1 votë e Përmbytur, mbështetet propozimi për përfshirje në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje, edhe pikat shtesë si në vijim, sipas materialit të prezantuar në këtë mbledhje.

- **Propozim vendim - ndryshim-plotësimi, përkatësisht riformulimi i të dhënave në kuadër të Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-463/06-0078836 të datës 11 dhjetor 2024, dhe atë: E dhëna kadastrale e pronës, renditur në nr.22 të Listës, konkretisht te Periudha kohore për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, ku thuhet Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër, riformulohet si vijon: Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë.**

- **Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës - Njësia kadastrale P-71712029-00202-3, në sipërfaqe 137157 m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm**

- **Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të kësaj prone**

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, dua të bëjë një pyetje lidhur me seancën që do të mbahet nesër, se a do të fillojmë nga pika 10 dhe vazhdojmë me pikën Të Ndryshme dhe mandej të fillon seanca e rregullt.

Kryesuesi i Kuvendit, përgjigje parafolëses, theksoi, po ashtu është siç e theksove zonja Arnisa, nëse të tjerë nuk ka të interesuar të marr fjalën atëherë e hedh në votim rendin e ditës së bashku me propozimet e reja që kanë hyrë si pika shtesë në këtë mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi konstatoi se nga 7 anëtarët prezent në sall, me 6 vota Për, asnjë votë Kundër, 1 votë e Përmbajtur miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje si dhe propozimeve të paraqitura si më lartë për përfshirje në kuadër të rendit të ditës si pika shtesë në këtë mbledhje.

Pikat e rendit të miratuar të ditës:

1. *Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 16 prill 2025*
2. *Draft Rregullore për Transparencë e Komunës së Podujevës*
- 2.1. *Draft Plani i Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2029*
 - *Raporti për ecurinë e konsultimit publik për: Draft Rregullore për Transparencë e Komunën e Podujevës, dhe Draft Plani i Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2029*
3. *Propozim vendimi për ngritjen e komisionit Ad-Hoc për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendës drejtorëve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës*
4. *Informatë për periudhën katër mujore të vitit 2025 - Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale*
5. *Propozim vendimi - për ndryshim-plotësimi, përkatësisht reformulimin e të dhënave në kuadër të Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-463/06-0078836 të datës 11 dhjetor 2024, dhe atë:
E dhëna kadastrale e pronës, renditur në nr.22 të Listës, konkretisht te periudha kohore për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, ku thuhet Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër, reformulohet si vijon: Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë.*
6. *Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës*
 - *Njësia kadastrale P-71712029-00202-3, në sipërfaqe 137157 m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm*
- 6.1. *Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të kësaj prone.*

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 16.04.2025

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, me 7 vota Për, nga anëtarët e Komitetit sa ishin prezent në sallë, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet procesverbali nga kjo pikë e rendit të ditës dhe atë sipas dokumentit të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

2. Draft Rregullore për Transparencë e Komunës së Podujevës

2.1. Draft Plani i Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2029

- Raporti për ecurinë e konsultimit publik për: Draft Rregullore për Transparencë e Komunën e Podujevës, dhe Draft Plani i Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2029

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, te kjo pikë e rendit të ditës i kemi dy propozime për arsye se e kanë pasur të njëjtin diskutim publik dhe të njëjtin raport dhe kështu që i kemi qitë në një pikë, pra bëhet fjalë për Draft Rregulloren për Transparencë në Komunën e Podujevës dhe Draft Plani i Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2029, bashkangjitur materialit gjeni edhe raportin dhe ecurinë e konsultimeve publike.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, pra si pikë e rendit të ditës e kemi Draft Rregulloren për Transparencë së Komunës së Podujevës, ku kjo rregullore është hartuar në përputhje me Udhëzimin Administrativ për administratë të hapur në Komunë, si dhe ka kaluar fazën e diskutimit publik, bashkangjitur gjeni edhe materialin së bashku me raportin e diskutimit publik kështu që ju ftoj ta përkrahini që të rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

znj. Sebastina Vokrri, theksoi, në emër të Grupit të LVV e përkrahim Draft Planin për Transparencë Komunale për vitet 2025-2029.

z.Naim Çunaku, theksoi, lidhur me këtë dua një sqarim, për derisa jemi duke folur për rregullore dhe nuk më kujtohet se kjo Draft Rregullore ka marr miratimin e Kuvendit për të dal në diskutim publik, nëse jam gabim kërkoj falje por sa më kujtohet mua nuk e di se ka kaluar këtë fazë.

Kryesuesi i Komitetit, përgjigje parafolësit, theksoi, është e vërtetë ajo që ti e theksove por pas konsultimeve që janë bërë është marr si përfundim që nuk ka qenë e nevojshme për miratimin e Kuvendit për të dal në diskutim publik dhe është arsyetuar në raport kjo çështje që nuk ka kaluar nëpërmes Kuvendit, mirëpo diskutimi publik është mbajtur dhe është sjell në Kuvend.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues, unë nuk e di se çfarë ka thënë zyra ligjore, mirëpo një rregullore që duhet të miratohet në Kuvend, paraprakisht duhet të merr vendimin e Kuvendit si draft rregullore dhe Kuvendi vendos se çfarë po lëshon në publik për diskutim, unë mendoj që është shkelje, jo që është ndonjë gjë por është shkelje dhe si e tillë mendoj që e ka bërë kapërcimin e hallkave të vendimmarrjes.

(Zyrtar i Zyrës Ligjore Enis Sheholli, jep disa sqarime lidhur me këtë çështje që u ngrit sa i përket konsultimit publik duke theksuar se është fakt që ka qenë praktikë e të kaluarës për t'i sjellë në Kuvend dokumentet e tilla që kanë për t'iu nënshtruar diskutimit publik edhe pse as në atë kohë nuk ka qenë e rregulluar me dispozita ligjore që fillimisht të miratohet në Kuvend si draft për vënie në diskutim publik, pra që të jepet pëlqimi, mirëpo tani e kemi një Udhëzim Administrativ që është miratuar në vitin 2023 për Administratë të hapur në komunë, dhe nuk theksohet një gjë e tillë, pra e ka përjashtuar atë praktikë dhe nuk obligohet që një dokument të shkoj në Kuvend paraprakisht për të marrë pëlqimin për diskutim publik, madje në këtë Udhëzim në një rast thuhet që iniciuesi apo propozuesi i akteve dhe politikave të parapara në nenin 22 ku janë edhe projekt rregulloret apo draft rregulloret, është përgjegjës për zhvillimin e procedurave të procesit të konsultimit publik, rregulla e njëjtë procedurale e konsultimit publik vlejnë edhe në rastet e projekt propozimeve të grupeve të jashtme, para aprovimit të një akti propozimi, e që për momentin tani e kemi për aprovim, pra organi propozues vendos për hapjen e procesit të konsultimit publik. Pas kësaj në nenin 19 të Udhëzimit në fjalë ceket Komuna..., po e përmend këtë sepse kanë pas dilema edhe komunat tjera por që pastaj kanë marr një konfirmim nga Ministra e cila është hartuese dhe sponsorizuese e këtij Udhëzimi dhe kanë thënë që nuk parashihet kjo që u ngrit si dilemë, por e kanë lënë që vetëm Komuna zhvillon konsultimin publik si transparencë. Përveç kësaj në këtë Udhëzim një prej neneve thotë që Komuna organizon konsultime publike me qytetar në përputhje me parimin e Ligjshmërisë Transparencës Barazisë Mos diskriminimit, dhe nuk përmendet askund as Kuvendi dhe as Ekzekutivi por që më pastaj ndërlihet me atë që iniciuesi e bënë hapjen e konsultimit publik, përveç disa vendimeve dhe akteve që kërkohet të marrin paraprakisht miratimin në Kuvend për konsultim publik, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me dokumentet e planifikimit hapësinor që specifikohen me ligj por edhe ndonjë akt i cili shprehimisht kërkohet me ligj që paraprakisht të vendoset në Kuvendin e Komunës për t'iu nënshtruar procesit të konsultimit publik.

Ju kërkoj falje për këtë sqarim i cili ka të vetmin qëllim heqjen e dilemave të ngritura sepse fakt ashtu siç u tha ka qenë praktikë në të kaluarën, përndryshe kjo të konsiderohet vetëm si sqarim nga ana ime sepse në disa raste u përmendëm ne si Zyrë dhe e pash të arsyeshme të marrë fjalën rreth kësaj çështje sot në këtë mbledhje të KPF-së në mënyrë që të mos ngritët sërish e njëjta në mbledhjen e Kuvendit).

z.Naim Çunaku, theksoi, unë edhe një herë po e potencoj që nuk kesh ai që dua të kundërshtoj sepse fundja më vjen mirë që kemi arritur, edhe pse vonë, të kemi një Plan të veprimit për transparencë, por me ato që zyrtari parafolës i përmendi dhe që u bë palë në diskutim me e lejen ton, unë them që kemi të paktën tre udhëzime që e rregullojnë këtë lëmi siç është Udhëzimi Administrativ për standardet minimale të konsultimit publik, Udhëzimi Administrativ për hartimin e akteve komunale dhe Ligji për

vetëqeverisjen lokale, dhe këto të tria e rregullojnë atë që e thash më herët unë, ndërsa në këtë kuptimin që u potencua ...Komuna, vërtetë që Komuna është marrë si institucion, por Komuna përbëhet nga dy pjesë që është legjislativi dhe ekzekutivi dhe që organi më i lartë është Kuvendi, mirëpo kur u përmend Komuna, gjithmonë folët si tersi si për Kuvendin ashtu edhe për Ekzekutivin.

Sido që të jetë, qëllimi im ishte që të mos bëjmë diçka që nuk është në përputhje me normat dhe sërish po e theksoi që është shumë mirë që është bërë një Rregullore për transparencë, edhe pse shumë e vonuar.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ka të interesuar për të marr fjalën rreth kësaj pike, nëse jo atëherë e hedhë në votim Draft Rregulloren për Transparencë e Komunës së Podujevës dhe Draft Planit i Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2029, sipas materialit përkatës, që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim në mbledhjen e radhës.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se nga 7 anëtarë/e të Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, me 3 vota Për, asnjë votë Kundër, 1 votë Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të Draft Rregullores për Transparencë e Komunës së Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Ndërsa,

Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të Draft Planit të Veprimit për Transparencë Komunale 2025-2029, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, vetëm dua ti përgjigjem z.Naim Çunakut i cili më herët e theksoi që prona në fjalë është dhënë në shfrytëzim, mirëpo vetëm sa më konfirmuan nga zyra kadastrale që nuk është as në sistem që i shkruan “në dhënie në shfrytëzim” dhe nuk ka as kontratë aktive për këtë parcelë që është në shfrytëzim.

z.Naim Çunaku, theksoi, e nderuar drejtoresh, unë e theksova dhe aq sa më punon memoria se ka qenë e dhënë ajo pronë, jo që është e dhënë kjo pronë. Nuk më pengon nëse ti ke të drejt sepse unë nuk jam i gjithëdijshtëm dhe as i pagabueshtëm, që të dyja e pranoj që i kam, mirëpo memoria ime më thoshte që ajo pronë është dhënë dhe ai personi që e ka marr në shfrytëzim është tërhequr, por nuk dua tani që të hyj në detaje.

3. Propozim vendimi për ngritjen e komisionit Ad-Hoc për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendës drejtorëve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, sa i përket kësaj pike, e dini që është praktikë që edhe herëve të tjera është formuar komisioni nga Drejtoria e Arsimit ku kjo Drejtori është e obliguar që të sjell në Kuvend për votim anëtarët e komisionit.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, përshëndetje për të gjithë, para vetës keni një propozim vendim për ngritjen e komisionit Ad-Hoc për përzgjedhjen e drejtorëve/shave dhe zëvendës drejtorëve/shave në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Podujevës ku nga Drejtoria e Arsimit propozohet të jenë Blerim Vllasa dhe Bahrije Talla kurse zakonisht prej Ministrisë së Arsimit në momentin kur aprovohet ky vendim e dërgojnë një emër që i përshtatet shkollës dhe kualifikimit përkatës të asaj shkolle.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, kam një pyetje për drejtorin parafolës, dua të di se me çfarë kriteresh janë përzgjedhur anëtarët e këtij komisioni, për z.Blerim Vllasa e kuptoj që është zyrtar i arsimit, por shembull Bahrije Talla me çfarë kriteri është zgjedhur.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, ndoshta unë nuk pata mundësi të kuptoj mirë, edhe pse e kam materialin dhe e kam lexuar, në një aspekt po më duket e padrejtë që t'i votojmë dy persona që neve nuk na japin asnjë raport, pra cila është arsyeja t'i votojmë na ata, nëse drejtori i DKA-së i zgjedh dhe atij i japin raport atëherë përse unë të votoj për këta, unë këtë nuk po mund ta kuptoj pse të ngris dorën lartë për të votuar për Blerim Vllasën dhe qysh mund t'i them unë atij nesër të më jep raport mua. Pra unë mendoj që në këtë komision është dashtë të jetë edhe ndonjë anëtar i Kuvendit në mënyrë që të dimë se çfarë po bëhet aty, prandaj edhe njëherë pyes cila është arsyeja që ne t'i votojmë ata kur drejtori i DKA i ka zgjedhur, përndryshe nëse drejtori do i kishte sjell që ne në Kuvend t'i zgjedhim ata anëtar të komisionit në fjalë dhe që të na raportojnë neve pastaj, do të ishte në rregull.

Personalisht nuk i njoh ata persona dhe nuk e di as kush janë, por unë t'jua jap të drejtën atyre që ta zgjedhin drejtorin e Orllanit atje ta zëm, kjo nuk do të ndodh.

z.Haki Rudari, theksoi, në bazë të nenit 3 të propozim vendimit, komisioni punët dhe detyrat i kryen në pajtim me dispozitat e Ligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, pra po e përsërisë që formimi i këtij komisioni është komfor ligji dhe natyrisht që ne e përkrahim formimin e këtij komisioni për arsyeje se parashihet me ligj, dhe po ashtu parashihet edhe një përfaqësues nga Ministria e Arsimit që e ka të drejtën e vetë të propozoj anëtarin, ndërsa ne si Kuvend Komunal kemi të drejtë t'i propozojmë vetëm përfaqësuesit nga Komuna jon.

z.Naim Çunaku, theksoi, derisa përafërsisht atë që e tha kolegu paraprak Ekrem Rrahmani, nuk janë llogaridhënës të Kuvendit ai komision, dhe z.Haki Rudari e citoi që në bazë të ligjit, dhe aty i kemi tre emra ku dy prej tyre që na lexove se kush janë dhe i treti që është i zbraztë që është i Ministrisë, nëse duhet të merret aprovimi i Kuvendit, edhe në vitin e kaluar e kemi pasur këtë temë me drejtorin e DKA dhe unë sa kam njohuri dhe është e vërtetë që nuk e kam konsultuar ligjin, por sigurisht te kandidati që zgjedhet të paktën tek njëri prej tyre duhet të ketë alternativë dhe nëse Kuvendi i Komunës nuk ka alternativë por vetëm të marr propozimin saktësisht se si e ka propozuar Drejtoria e Arsimit, në një formë votimi në Kuvend vërtetë e merr atë që e theksoi z.Ekrem Rrahmani, që bëhet i pakuptimtë.

z.Bashkim Sylja, theksoi, unë mendoj që ky propozim vendim që ka ardhur nga Drejtoria e Arsimit është në bazë të ligjit dhe zakonisht secila parti politike që i fiton zgjedhjet e ka shumicën në Kuvend dhe e ka përgjegjësinë e zhvillimit të arsimit, kështu që ligji i përcakton këto, pra është përgjegjësi e pushtetit t'i krijon numrat që të miratoj këtë komision, ndërsa sa i përket Kuvendit unë mendoj që na pasi të bëhet përzgjedhja e drejtorëve nëse mund të dakordohen të gjitha partitë politike të formojnë një komision që të shqyrtoj procesin se a ka shkuar transparent apo jo, mirëpo ne të gjithë e dimë qysh janë zgjedhë drejtorët. Është përgjegjësi e pushtetit dhe unë mendoj që edhe të tjerat Komuna kështu veprojnë, pra edhe një herë po e theksoi që është përgjegjësi e pushtetit t'i bëjë numrat dhe të formohet komisioni në fjalë, këta i kanë përzgjedhur njerëzit e vetë dhe mundohen t'i shtinë njerëzit e vetë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuari z.Bashkim Sylja, unë nuk jam as kundër tyre, por e theksova që nuk votoj një person që nuk më jep llogari mua si anëtar i Kuvendit të Komunës, nuk e thash përse nuk janë zgjedh dy të tjerë sepse nuk më intereson ajo punë, por nëse drejtori i DKA-së ka pas të drejtë t'i zgjedhë atëherë përse t'ia votoj unë, prandaj e ceka që një anëtar apo person që nuk i jep llogari këtij Kuvendi unë nuk e votoj, kjo është arsyeja dhe nuk diskutova për emrat e propozuar, por nëse nuk më jepet mua e drejta që t'i propozoj këta anëtar dhe që pas tre muajve të mund t'i thërrasim për të dhënë llogari këtu në Kuvend, atëherë unë nuk i votoj.

z.Bashkim Sylja, theksoi, pajtona plotësisht me ty i nderuar koleg z.Ekrem Rrahmani, edhe unë mendoj ashtu dhe e theksova që është përgjegjësi e partisë në pushtet që t'i bëjë numrat për t'i kaluar personat që i ka propozuar vet, pajtohem plotësisht me parafolësin që nuk ka asnjë obligim për t'i bërë numrat dhe as për të votuar. Pra edhe njëherë e them se edhe unë pajtohem me këtë sepse nuk mund të shikojmë se si po

shkon ai proces, por nëse jemi në dakord të gjitha partitë politike që pasi të bëhet zgjedhja e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mund ta shikojmë procesin se si ka shkuar.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, dy anëtarët e zgjedhur nga Drejtoria e Arsimit nuk mundemi ne si Kuvend t'i sjellim për raportim në Kuvend, ky është problemi. Nëse pak më parë në rend të ditës ishte pika për transparencë, dhe tani kemi këtë pikë e cila e godet transparencën, çfarë të themi më shumë.

z.Haki Rudari, theksoi, secila Drejtori e ka fushëveprimin e saj, që unë jo rastësisht bazohem në Ligjin për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, pra ky Ligj nuk vlen vetëm për Komunën e Podujevës, besoj që edhe ju kolegë të nderuar i shikoni edhe Kuvendet Komunale të vendeve të tjera, pra është e njëjta mënyrë në Kuvendet Komunale që formohet komisioni për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave. Neni 4 i këtij propozim vendimi thekson që për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Arsimit, pra ne e kemi Drejtorinë e Arsimit dhe në këtë rast formimi i komisionit është në kompetencë të kësaj Drejtorie, në të ardhmen mund të kërkojmë raporte të ndryshme, por formimi i komisionit parashihet me Ligj dhe Kuvendi Komunal ka obligim ta miratoj.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, ju e dini që kjo nuk është hera e parë që ka ardhur një propozim i tillë në Kuvend, propozimet e tilla janë të bazuara në Ligj dhe në Udhëzim Administrativ si dhe gjithashtu në Rregullore që e keni para vetës, pra nuk i bënë vetëm Komuna e Podujevës por edhe komunat tjera, duke e përfshirë edhe Komunën e Prishtinës ku ju si parti jeni në udhëheqje, pra nuk ka diçka të jashtëzakonshme këtu. Ajo që është kërkuar nga ju, aty theksohet që një zyrtar duhet të propozohet nga Drejtoria e Arsimit e që në këtë rast është Blerim Vllasa, pastaj kërkohet një pozicion i nivelit drejtues e në këtë rast është znj.Bahrije Talla, ku për fat i ka ra që ta kryej konkursin më herët dhe nuk është në garë tani, pra me këtë dua të them që nuk është në garë kjo dhe nuk është e zgjedhur për ndonjë arsyeje tjetër të caktuar. Ju sërish po thoni që nuk jeni kundër, ndërsa po atakoni emra që nuk do duhej të atakohen emrat e asnjë drejtuesi, çdo secili e ka përgjegjësin e vetë të shkollës edhe prej vendit nga vjen që në këtë rast anëtari i Kuvendit z.Ekrem Rrahmani e ka një drejtor të fshatit të vetë që ka fjalë të mira për të dhe dihet politikisht ku ka qenë i orientuar edhe atëherë por edhe tani, kështu që nuk duhet të bëjmë krejt këtë punë politike dhe esenca qëndron këtu që ne duhet të punojmë të gjithë së bashku dhe t'i pranojmë faktet që nuk ka të interesuar për drejtor për shkak të nivelit të pagës jo të kënaqshëm, pra është diferencë 30-50 euro, ky është problemi kryesor dhe pajtohem me z.Bashkim Sylën i cili e theksoi që jemi të interesuar që ky proces të kryhet me transparencë, por që unë vetëm sa u informova që gjatë aplikimeve në shumicën e shkollave është vetëm nga një aplikim dhe nuk ka të interesuar shumë, mirëpo jemi të interesuar që ky proces të shkoj në mënyrë sa më transparente, mirëpo për raportim i nderuar zotëri Rrahmani është e pakuptimtë të vijë çdo njëri drejtor të raportoj këtu, por për çdo gjë që ju intereson juve ne e kemi edhe planin që duhet të vijë unë si drejtor i DKA të raportoj këtu në Kuvend e që edhe jam munduar të jem korrekt po aq sa kam pasur mundësi dhe ta bëjmë këtë proces sikurse të gjitha komunat tjera dhe të mos del që Komuna e Podujevës është duke e bërë diçka të jashtëzakonshme, po e theksoi që është obligim ligjor, është procedurë që propozohet kështu ku edhe e kemi bërë këtë, dhe pa keqkuptime po e them që nuk është hera e parë që nuk po e votoni.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, më sa duket jam keqkuptuar, unë e theksova që logjikisht komisioni që e përzgjedh drejtori i DKA-së për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave, unë nuk e votoj sepse drejtori i ka përzgjedhur dhe unë nuk e di se si e ka bërë përzgjedhjen, unë personalisht me këta dy persona asgjë personale nuk kam por nuk i votoj sepse nuk mund të kërkoj përgjegjësi prej tyre, pra nuk dëshiroj që t'i votoj nëse unë si kam propozuar ata anëtarë, sepse për mendimin tim kjo procedurë është e gabuar për arsyeje se qysh mundet që drejtori t'i propozoj e unë t'i votoj ata persona, sipas mendimit tim kjo nuk ka kuptim.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, zotëri Ekrem unë personalisht e kam lexuar atë Rregullore dhe ajo rregullore e parasheh këtë procedurë, pra nuk është bërë për dëshirë të askujt, le të jemi të qartë se në bazë të asaj Rregulloreje ka ardhur edhe ky propozim vendim.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar drejtor e potencove që nuk është hera e parë, edhe unë gjatë fjalës time e potencia që nuk është hera e parë, por herën tjetër kur përafërisht kam thënë, pse nuk kemi alternativa tjera përgjigja juaj ka qenë që është një alternativë përmes asaj që t'i sjellim dy emra dhe më duket ka qenë i këshillit të prindërve, mirëpo ka ardhur kështu qysh ka ardhur edhe në atë kohë, mirëpo nuk po i jap vetes specifikisht të drejtë sikur z.Haki Rudari që po e thotë që ligji e përcakton, sepse janë gjëra që dihen ato, pra nëse ligji është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ai ligj të obligon pa dallim partie, por varet shumë në dorë të kujt bije ligji dhe si e aplikon ligjin dhe këtu lindin dyshimet.

Plotësisht pajtohem me kolegun z.Bashkim Sylja i cili e theksoi që partisë fituese i takon t'i qoj përpara politikat e veta, por ne në rolin tonë e bëjmë punën tonë siç na është përcaktuar me ligj dhe në bazë të demokracisë, pra këtu mendoj që jemi të gjithë bashkë dhe nuk na pengon, mirëpo tani dua të di më specifikisht i nderuar drejtor i DKA-ës se a parasheh ligji alternativë për votim në Kuvend apo është fiks që duhet dy emra t'i propozoj Drejtoria e Arsimit apo duhet që kjo Drejtoria t'i propozoj më shumë se dy emra dhe Kuvendi të zgjedh për alternativë që e voton.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, dua të ndërlihem tek çështja e emrave që u përmenden, ne nuk u ndalëm në emra të përveçëm i nderuar drejtor i DKA-së, por meqë je duke i përmendur si emra të përveçëm neve na intereson se si janë përzgjedhur këta dy emra, përndryshe nuk kemi problem ne me asnjërin prej këtyre emrave.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, e nderuara zonja Arnisa unë nuk ju drejtova juve, por me të vërtetë është për keqardhje kur atakohen emrat e përveçëm duke thënë terma si, shembull që unë nuk mund të duroj atë e gjëra të tjera, sepse Ekremi i përmendi dhe nuk është mirë që të përmenden sepse çdo njëri ka një familje dhe nuk është diçka që kanë luftuar për të ardhur këtu, por kanë qëlluar këtu, njëri punon në DKA tjetra është drejtoresh në shkollë, pra ne e kemi për obligim që t'i propozojmë dhe bazën ku e kemi propozuar ju e keni një dëshmi të qartë që në këtë rast ka ardhur komplet edhe me emra sepse herëve tjera nuk ka ardhur me emra, pra e keni bazën ligjor ku jemi bazuar në Rregulloren që është nxjerrë në muajin gusht 2024 dhe nuk ka asnjë komunë tjetër që vepron ndryshe, pra i'u besojmë profesionistëve tanë që e kanë përgatitë.

Pra, e jona është që të sjellim këtë propozim këtu dhe e juaja është që të votoni ose mos të votoni, nëse nuk dëshironi t'i votoni atëherë vazhdojmë me ushtrues detyre, mirëpo kemi qenë të interesuar të krijojmë një variant të mirë që jo në fushata zgjedhore me qenë proces se si i kemi zgjedhur me mandat të ushtruesit të detyrës, por ta kenë një mandat pa marr parasysh animeve politike, drejtoria ta ketë mandatin e tij dhe të kryej punët e tij në shkollë. A jemi të interesuar që drejtorët e shkollave të kenë një pagë më të mirë, po jemi të interesuar dhe duhet të ketë sepse me këtë page nuk ka interesim, jo vetëm në Komunën e Podujevës por edhe në komunat tjera.

z.Naim Çunaku, theksoi, me qëllimin më të mirë e thash që në fillim se do të ishte mirë që politika të hiqte duart nga arsimit. I nderuar drejtor i DKA-së, unë saktë e di që këtu është përmend Bill Gates, dhe ligji nuk është për të gjitha preferencat si dhe nuk është e obligueshme që t'i pëlqej çdo njërit sepse pëlqimi është ndjesi individuale e që këtu jemi në rregull, mirëpo edhe njëherë po e përsërisë që gjërat që nuk i di jam shumë korrekt dhe di të kërkoj falje, madje edhe mund të tërhiqem, por mua mu kujtua kur në vitin e kaluar të kam bërë pyetjen se a parasheh ligji alternativë, ti drejtor ke thënë po, pra këto janë produkte të ligjit dhe unë siç e thotë ligji mendoj, nuk ka rëndësi se çfarë thotë Rregullorja, pra nëse Rregullorja është në kundërshtim me ligjin atëherë është zero ajo Rregullore dhe nuk vlen sepse ligji është ai që e përcakton.

Dua të potencoj edhe njëherë që nëse nuk ka tjetër alternativë ligjore që i jap hapësirë Kuvendit, pra që të ketë alternativë midis individëve, pa hyrë në preferenca ky ose ai, por nëse nuk ka alternative në vendimmarrje atëherë përse duhet të vendos Kuvendi kur nuk kemi alternativë, nëse kështu e ka paraparë ligji atëherë në rregull jemi.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, sa i përket Rregullores dhe Ligjit, duhet të jeni të vetëdijshëm se këto dyja e plotësojnë njëra tjetrën për këtë punë dhe më besoni që kjo Rregullore i ka lehtësuar shumë punën komunave për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve arsimore, pra kjo vlen për të gjitha komunat dhe e thekson shumë qartë se duhet të ketë 240 kredi, të ketë planin zhvillimor të asaj shkolle, dhe çfarë është më interesant se duhet të ketë menaxhimin adekuat që lidhet me fushën e caktuar e që pa keqardhje e them se shumica janë të subjektit që ju e përfaqësoni, kështu që Rregullorja e ka bërë më të lehtë punën që garës t'i hyjnë njerëzit profesionist.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ka të interesuar tjerë për të marr fjalën, nëse jo atëherë e hedhë në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, me 6 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në sallë, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij propozim vendimi, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

4. Informatë për periudhën katër mujore të vitit 2025 - Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

znj.Adelina Stublla, drejtoresh e DSHMSH, theksoi, kjo pikë e rendit të ditës është sipas Planit të punës së Kuvendit, e cila faktikisht është një pasqyrim i shërbimeve të të gjithë sektorëve, pra është një përmbledhje duke filluar nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare dhe njësit tjera përcjellëse, Qendra për Punë Sociale, Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kështu që është një përmbledhje e të gjitha informacioneve lidhur me periudhën katër mujore.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, mendoj që Ekzekutivi është dashtë të marr shembull drejtoreshën e DSHMS, edhe pse nuk janë disa gjëra të paraqitura në këtë raport, mirëpo me vetë faktin që ka ardhur dy herë në vit dhe ka raportuar para Kuvendit, këtë gjë e respektoj dhe e ka votën për.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, ne Grupi i LVV e mbështesim informatën e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për periudhën katër mujore të vitit 2025.

z.Naim Çunaku, theksoi, edhe unë e nderuara drejtoresh e DSHMS i bashkohem përgëzimeve që ke treguar përgjegjësi para Kuvendit si organ që e monitoron punën e Ekzekutivit dhe në këtë drejtim të përgëzoj, ndërsa te Qendra për Punë Sociale nëse ka mundësi që nesër të na informosh se si është ka shkon trendi i familjeve në nevojë gjatë këtij viti dhe viteve të kaluara, pra një krahasim se a është rritur apo zvogëluar numri i familjeve me asistencë sociale, në këtë drejtim do të doja të kemi një pasqyrë statistikore me qëllimin e vetëm të dimë se si po qëndron kjo gjë.

z.Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ka të interesuar tjerë për të marrë fjalën, nëse jo e hedhë në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, me 7 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim të kësaj Informate, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

5. Propozim vendimi - për ndryshim-plotësimi, përkatësisht riformulimin e të dhënave në kuadër të Listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2025, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-463/06-0078836 të datës 11 dhjetor 2024, dhe atë: E dhëna kadastrale e pronës, renditur në nr.22 të Listës, konkretisht te Periudha kohore për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, ku thuhet Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatshkurtër, riformulohet si vijon: Njësia kadastrale planifikohet të jepet në shfrytëzim afatgjatë.

z.Kryesuesi i Komitetit, theksoi, tani kemi pikat e rendit të ditës të cilat hyrën si pika shtesë në këtë mbledhje dhe për të cilat besoj u sqaruam mjaftueshëm në fillim të mbledhjes, andaj po vërejë se nuk ka të interesuar për të marrë fjalën dhe për sqarime apo informata shtesë rreth këtyre pikave, kështu që i hedh në votim këto pika të rendit të ditës që t'i rekomandohen Kuvendit për shqyrtim, sipas materialit përkatës të prezantuar në këtë mbledhje i cili sigurisht që i'u dërgohet anëtarëve të Kuvendit së bashku me konstatimet e rekomanduara nga kjo mbledhje e KPF-së.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, me 7 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtij propozim vendimi, sipas materialit përkatës të prezantuar / shpërndarë në këtë mbledhje, i cili është edhe pjesë përbërëse e këtyre rekomandimeve të KPF-së.

5. Propozim vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës - Njësia kadastrale P-71712029-00202-3, në sipërfaqe 137157 m², Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm

5.1. Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të kësaj prone

Pas votimit, Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të këtyre Propozim vendimeve në këtë pikë të rendit të ditës, sipas materialit përkatës të prezantuar / shpërndarë në këtë mbledhje të KPF-së, i cili është edhe pjesë përbërëse e këtyre rekomandimeve.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50

**Procesverbalin e mbajti;
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0071471/24
Podujevë,
27 maj 2025**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit
Hilmi Hoxha**